

PRANUAR MË: 12-11-2018
ACCEPTED ON: 12-11-2018
MAILJENO:
Nr.No.Br. 02/464

REPUBLICA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr. 02/
Datë: 12.11.2018

Procesverbal
i mbledhjes së II (dytë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi i shkresës së MAPL-së, nr.020-1138/3 datë:12.10.2018 në lidhje me:
 - a. Rishqyrtimi i Vendimit nr.02/382 datë:02.10.2018
 - b. Rishqyrtimi i Vendimit nr.02/383 datë:02.10.2018
 - c. Shqyrtimi fillestar i Propozim-Buxhetit të Komunës së Malishevës nr.04/125 datë: 22.10.2018 për vitin 2019-2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës
 - z. Ragip Begaj.

Mbledhja u mbajt me datë:22.10.2018, në ora 14:30, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim. Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve ju njoftoj se nga MAPL ka ardhur një shkresë rreth buxhetit që kemi dërguar dhe ata kanë shkruar që ka pasur shkelje procedurale në miratimin e buxhetit, është dorëzuar me vonesë, mos mbajtja e dëgjimeve publike në Kuvend por nga Kryetari. Ne u dakorduar me Kryetarin e Komunës që sot me thirr një mbledhje urgjente edhe pse Drejtorja e vonoi buxhetin me na dorëzuar por mirë është që ne ta trajtojmë në afatin ligjor dhe ta dorëzojmë në Ministri e ata në Qeveri. Unë shkresën e Ministrisë po ju lexoj ashtu qysh thotë se buxheti nuk është dorëzuar deri me 30 Shtator, kuvendi ska mbajtur dëgjime publike e që gjitha këto shkelje janë bërë nga Kryetari i Komunës. Unë në facebook s'kam dashtë të reagoj por me kanë shtyre të reagoj disa drejtor, shkelje tjetër ka qenë largimi i stafit prej mbledhjes nga Kryetari, por pushtetet janë të ndara Kuvendi është sovran. Për këtë mbledhje materialin e kam shpërnda, kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht 4 anëtarë ishin për, hapi debat.

Veç po ju njoftoj se nesër në ora 11 e kemi një takim të kryetari të gjithë shefat e grupeve në Kuvend. Alban Krasniqi: Të çështja e buxhetit trajtimin ose sjelljes së administratës karshi detyrave të veta e me pengun punën e Kuvendit është një lloj veprë penale nga ana e kryetarit. Buxheti ka ardhur tash në këtë gjendje falë ndërhyrjeve politike se sa nga shkeljeve përmbajtjesore e që unë në mbledhje do t'i falënderoj deputetet e opozitës për punën dhe kohën e treguar lidhur me buxhetin. Opozita ka përdorur praktike të ligjshme me buxhetin e propozuar për ndryshimet buxhetore, e kryetari dhe drejtori kanë dështuar me dorëzuar me kohë, kanë penguar në punën e kuvendit, sjelljen e informacioneve, kanë dështuar me dorëzuar dokumente në formën elektronike e pas gjitha këtyre ne kemi dhënë një version human sesa atyre shkarravinave që kam cek edhe në facebook ne kemi miratuar një buxhet me të njëjtat shuma, sepse ai buxhet që na kanë sjellë ka qenë shkarravinë me zëra buxhetore tjerë e më shuma marramendëse me mbulu ndonjë shpenzim e që s'kanë dhënë as një përgjigje. Ne ja kemi kthyer një pamje njerëzore buxhetit komunal, Kryetari ka bërë një kërkesë në MAPL e ajo përgjigje ska të bëjë asgjë me kërkesën e Kryetarit e që s'është hera e pare. Ne në mbledhjen e Kuvendit shfuqizojmë dy vendimet kthehemi në pikën fillestare e për mua ka mu paraqitë i njëjti buxhet me propozimet e opozitës për plotësim dhe ndryshim të buxhetit të merr fund. Shqetësim mbetet qysh ka mu hargju buxheti, kemi shumë projekte pa zbatuar e rrezik është kualiteti i punëve. Vërejtjet i kemi ngritur në MAPL për sjelljet e pushtetit, hapësirë të diskutimeve ka me pas çdo ditë e më pak, zyrtaret ta masin vetën e jo me dalë jashtë me urdhër të çdo kujt, zyrtaret i informimit duhet me ditë kush i merr minutat e informimit e jo me ardhur çdo kush aty nëse është dikush tjetër le të del mbrapa, paisjet s'kanë mu marrë se lojnat politike ata le t'i mbajnë për veti zyrtaret të mbajnë pozicion neutral.

Raimonda Krasniqi: E çmoj punën e opozitës për angazhimin për buxhet, disa herë kryetari në mbledhje ka thënë buxhet paralel por ai buxhet aty kishte paraqitje të projekteve dhe shumë shpejt do të zbatohet në të mirë të qytetarëve të Malishevës. Është punuar me përkushtim dhe maturi, sepse qeverisja Begaj i ka etiketuar ata që janë apo s'janë me Nismën, ne ju kemi thënë se nëse mbështeteni në ligj ne do tju përkrahim. Nuk e përkrahim injorimin, arrogancën, sjelljet rrugaçërie të disa nga drejtorët, sepse menjëherë mbas mbledhjes kryetari ishte dashtë ta shkarkoj drejtorin e Financave. Kryetari disa herë ka thënë ndihmomëni t'i zejmë hajnat e tani nuk i paraqet shkeljet e veta në secilin sektor thotë shpenzime tjera e që janë me mijëra euro pra paraqiten të tjera, pastaj te rasti i Gjykatave. Shqetësim është edhe me punimet shkel e shko sepse muaji tetor nuk është janar që nguten. Kryetari të veprojnë ndaj personave të qeverisë që përdorin dhunë dhe arrogancë.

Valon Krasniqi: Tash neve na bënë edhe më të lehtë dhe tash i dimë procedurat, ajo që na shqetëson është situata gjatë mbledhjes së Kuvendit por s'është paraqitur krejt bërthama e krejt situatës nga zyra për Informim, të informohet krejt opinioni. Unë vërtet ndoshta atë ditë e kam ngrit zërin por duhet marra masa në atë ushtrues detyre të atij drejtori që ka bërë thyrje të ligjit e jo të shqetësohet edhe familja ime. Mos te ishte opozita nuk ishte sot aj projekt për banim social, pse mos të falënderohen edhe opozita kur ju kemi bërë të mundshme.

Raimonda Krasniqi: Ne para se të fillojmë mbledhjen duhet të kerkojmë sqarime për gjendjen atë ditë.

Rrahim Morina: Gjitha këto shqetësime duhet t'i cekim por ne ja kemi kthyer dinjitetin kuvendit, sepse s'është llogaritur as si zyre. Në asociacion i kemi paraqitur të gjitha shqetësimet s'janë kanë në gjendje 1 muaj një zyre me lëshuar, pastaj sjellja e drejtorëve, duhet me gjetë bashkëpunim se sot formës së debatit i ka ardhur fundi.

Kush jeni që këtë kërkesë të projekt buxhetit ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Alban Krasniqi: Unë kam me kërkuar deri në detaje punën e zyrës për informim e që edhe ju mu liru prej përgjegjësive.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30 minuta.

Procesmbajtësi:

Naim Avdiqaj jur. i dip

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

